

VENDIM
Nr.454, datë 16.4.2008

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.478, DATË 18.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesa dhe ndryshimi, si më poshtë vijon:

a) Në fund të shkronjës “a” shtohen emërtimet “Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe Agjencia Shqiptare e Biznesit dhe Investimeve”.

b) Në shkronjën “b” emërtimi “Agjencia Shqiptare e Biznesit dhe Investimeve” shfuqizohet.

2. Punonjësit e tjerë të Inspektoratit Ndërtimor dhe Urbanistik Kombëtar dhe të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve të paguhën sipas lidhjeve II dhe II/M të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2008, të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion, për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha